



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.127/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Podujevë për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike-drunjë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Podujevë i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3,100.00 (*tremijë e njëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 në rrugën “Zahir Pajaziti” në Podujevë, aktivisti i tyre ka vërejtur se në hapësirë publike-drunjë ishte vendosur posteri i një kandidate për deputete nga radhët e Koalicioni PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektit politik, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën nr.11/2013, nen 4.1, (b). Përkundër kësaj koalicioni ka ndërmarr masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar. Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA është vendosur në drunjë, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA është vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në hapësirë publike- drunjë. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga subjektit politik LVV, e datës 09.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.127/2017, të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj koalicionit PDK-AAK-NISMA, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është ne interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërsës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njërsës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr

posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.127/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

A large, handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rafet Haxhaj". It is positioned to the right of the stamp and text.

*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi
nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.
4 të LZP-së.*